

VENDIM
Nr. 55, datë 29.1.2020

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT ME SHKËMBIM LETRASH TË
MARRËVESHJES KUADËR TË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS, PËR
PUNËT E KOMUNITETIT IV, TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT,
PROJEKTI “ZHVILLIMI I ALPEVE DHE ZONAVE BREGDETARE”,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 69/2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit me shkëmbim letrash të marrëveshjes kuadër të financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për punët e komunitetit IV, të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, projekti “Zhvillimi i alpeve dhe zonave bregdetare”, ratifikuar me ligjin nr. 69/2015, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Logo BZHKE

Znj. Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3,
Tiranë
Shqipëri

Paris, 17 dhjetor 2019

Ref: LD 1853 FSHZH Shqipëri, Rialokim fondesh (FSHZH)

E nderuar Ministre,

Në referencë të shkresës suaj të datës 7 gusht 2019, kemi kënaqësinë të pranojmë kërkesën tuaj për rialokimin e fondeve të detajuara më poshtë.

Shuma në milionë EURO	BZHKE	Shqipëria dhe NjQV-të	KIBP	Totali
Kostot e investimit	28,5	5,0		33,5
<i>Punimet civile</i>	26,0	4,6		31,5
<i>Projektimi dhe mbikëqyrja</i>	1,6	0,4		2,0
Mallrat	0,2			0,2
Kostot e zbatimit dhe asistencës teknike	1,0	1,0	1,0	3
Kontigjencat				
Totali	29,7	6,00	10	36,7

Mbetemi në dispozicionin tuaj për çdo pyetje dhe ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin.

Me respekt,

Thierry Poiriel
Drejtor i përgjithshëm

Maria Bondar
Zëvendëskryetare e Divizionit të Shlyerjeve, Pagesave &
Kolateralit

55, avenue Kléber • F-75116 PARIS • Tél' +33 (0)1 47 55 55 00 • Faks: +33 (0)1 47 55 03 38 Swift: CEFPRPP • www.coebank.org
